

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

|"Intermediation Agency "

Shoqëria Shqiptare me Përgjegjësi të kufizuar " **Intermediation Agency**" SHPK, krijohet ne baze të aktit të Themelimit date 27.12.2021, nga Ortaku I Vetëm I kësaj Shoqërie **Flavio Elia**, I biri I Sebastiano dhe Maria, shtetas shtetas I datelindjes 14.06.1984, I lindur ne LECCE te Italisë dhe banues ne Lecce , mbajtes I Pasaportes me numer YB6231673 Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

I cili me vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me Ligjin nr 9901, date 14.04.2008, 'PER TREGTARET DHE SHOQERITE TREGTARE " dhe ligjit me nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" nepermjet Aktit te Themelimit, sot me date 27.12.2021, ka vendosur te jape kontributin e tij sipas percaktimeve qe percaktohen ne kete statut, per arritjen e objektivave ekonomik, duke destinuar ne nje sipermarrije pasurine tij, me qellim qe te ndajne fitimin ose qe te mund te perfitoje nga te ardhurat qe rrjedhin prej saj

Neni 2

Forma e shoqërisë, krijimi, personaliteti juridik

1. Shoqëria është organizuar ne formen e nje shoqërie Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar, ne kuptim te ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare "
2. Shoqëria emërtohet " **Intermediation Agency** ", është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, këtu e më poshtë "shoqëria"
3. Shoqëria fiton personalitetin juridik vetëm pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e caktuara me ligj.
4. Shoqëria, pasi te jetë regjistruar dhe të ketë fituar personalitetin juridik, përgjigjet ndaj të treteve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.
5. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne dispozitat e percaktuara ne dispozitat themeluese (Akt Themelimi dhe Statut)

Neni 3

Objekti i Aktivitetit

Shoqëria do te kryejë aktivitetin e kosulence biznesi dhe kosulenca te tjera administrative-menaxhimi

1. Menaxhimi I pasurive te paluajtshme ne emer te paleve te treta.
2. Sherbime te tjera mbeshtetese te biznesit te pa klasifikuara ndryshe.
3. Mardheniet me publikun dhe komunikimi.
4. Blerje shitje e pasurive te paluajtshme te kryer ne asetet e veta.
5. Marje me qera dhe menaxhimi I pasurive te paluajtshme ne pronesi ose me qera.
6. Aktivitete te tjera profesionale, shkencore dhe teknike te pa klasifikuara ndryshe.

FLAVIO ELIA

Neni 4
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje kohezgjatje te pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5
Selia dhe Adresat

Shoqeria e ka seline ne Adresen:

1. Rruga Kongresi I Tiranes,Pallati 256, Shkalla 1, Apartamenti 9, Tirane
2. Nr. kontakti per shoqerine eshte: 069 64 16 681
3. Adresa email e shoqerise eshte: eliaflavio@gmail.com

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakut te Vetem.

Kreu II

Neni 6
Kapitali i Regjistruar

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 (njqind) mijeleke,


Ortaku I vetem.....	Flavio Elia
% qe zoteron.....	100%
Kuota qe zoteron.....	1 kuote

Kapitali themeltar I shoqerise perfaqeson kapitalin e derdhur nga ortaku I vetem I shoqerise . Depozitimi I kapitalit te shoqerise do te behet, pas regjistrimit te shoqerise ne QKB. Ne librin e llogarive qe do te krijohet ne shoqerine tregtare do te shenohet dhe kapitali I derdhur nga ortaku I vetem I shoqerise. Rritja e kapitalit nga ortaku I vetem nuk eshte I kufizuar. Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Kreu III
Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Neni 7
Ortaku i vetem/Asambleja e ortakeve

1. Ortaku I vetem I shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
2. Ortaku I vetem I shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

FLAVIO ELIA


3. Ortaku I vetem I shoqerise eshte pergjegjes per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
- Ndryshimin e statutit
 - Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
 - Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
 - Percaktimin e shperblimeve per administaret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar
 - Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administraret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
 - Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
 - Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
 - Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
 - Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
 - Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti
4. Cdo ndryshim i statutit te shoqerise do te depozitohet prane QKB-se, sipas rregullave perkatese per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Administratori/et

Neni 8 Emerimi i Administratoreve


- Ortaku I vetem I Shoqerise eshte njekohesisht dhe Administratori I shoqerise**
- Administratori/et do te konsiderohet me te gjitha te drejtat qe u jep legjislacioni ne fuqi

Neni 9

Kompetencat dhe pergjegjesite e Administratorit

- Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

- kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare.
- perfaqesoje shoqërinë tregtare perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve.
- veproje ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqërise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji iu jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.
- te nenshkruaje kontrata te ndryshme ne emer e per llogari te Shoqerise, perfshi ketu kontratat e qirase, shitjes, blerjes a hipotekimit te pasurive te paluajtshme, te nenshkruaje aktet e themelimit te shoërive te tjera ku Shoqëria eshte ortak, te nenshkruaje e hartoje cdo dokument e te kryeje ne emer te Shoqerise cdo veprim perballe te gjitha Bankave shqiptare apo te huaja ne lidhje me celjen apo mbylljen e llogarive rrjedhese te Shoqerise, nenshkrimin e kontratave te ndryshme bankare per financimin e Shoqerise si dhe te kryeje veprime terheqje e derdhje shumash nga keto llogari pa limit.
- kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shocierise;
- kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit.
- kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

FLAVIO ELIA


B. Pergjegjesite

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.
2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Ortaku qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale pasojat perkatese.
3. Administratori sipas parashikimeve te bera ne ligjin " Per Shoqerite Tregtare " dhe parashikimeve te ketij statuti detyrohet gjithashtu:
4. Te kryeje detyrat e tij qe i ngarkohen sipas ligjit apo statutit duke respektuar parimin e mirebesimit dhe interesin me te mire te shoqdrise ne teresi.
5. Te ushtroje kompetencat e njohura nga ligji dhe statuti vetem per arritjen e qellimeve te caktuara nga keto dispozita
6. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem duke arritur te menjanoje rastet e konfliktit prezent apo te mundshem te interesave personale me ato te shoqerise.
7. Te gjitha pergjegjesite e detyrimet e tjera te parashikuara me ligj apo ne statut.

Neni 10

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

1. personi nuk eshte me Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te Ligjit;
2. personi ndodhet ne gjendje paaftesie pagueuse;
3. personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore;
4. personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine

Neni 11


Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve

1. Administratori shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga ortaku I shoqerise ne perputhje me parashikimet e Nenit 97 te Ligjit "Per tregtaret dhe shogerite tregtare".
2. Ortaku mund te parashikoje perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per cdo person i cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne shoqeri, shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shogeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per cdo familjar te tyre (perfshire bashkeshortin/en, ish-bashkeshortin/en) ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre, dhe mund te paguaje kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.

Neni 12

Dividend

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 Dhjetor. Parjashtimisht, viti I parë fillon nga data e rregjistrimit dhe mbaron më 31 Dhjetor.
2. Pas plotesimit te parashikimeve te Ligjit 9901, shoqeria e perfaqesuar nga ORTAKU i vetem mund te deklarroje shperndarjen e dividendeve

FLAVIO ECIA 

Neni 13
Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Administratori/et, pas vendimit te ORTAKUT te vetem duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit 9901, mund te vendosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividend preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise.

Kreu VI

Neni 14
Prishja dhe riorganizimi i shoqerise

1. Shoqeria me pergjegjesi to kufizuar prishet:
 - a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
 - b) me vendim te asamblesd se pergjithshme;
 - c) me hapjen e procedurave td falimentimit;
 - e) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";
 - d) me vendim te gjykates;
2. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Rregullat per proceduren e zakonshme te likuidimit dhe gjendjen e aftesise paguese jane Nenet 191 den ne 203 te Ligjit 9901.
3. Shoqeria likuidohet me procedure te thjeshtezuar, ne perputhje me nenet 204 dhe 205 te Ligjit 9901.
4. Ne rast te likuidimit te shoqerise, likuiduesi, ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e marre nga ortaku i vetem i shoqerise, mund te shperndaje ne dobi te ortakut te gjithe ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim, mund te vleresoje cdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes se saj.
5. Afati i emerimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrimit Tregtar.
6. Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve to vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

FLAVIO ELIA



Neni 15
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 17

Dispozita Perfundimtare

Ky Statut hartohet sot me date 27.12.2021 ne katër kopje identike ne gjuhën shqipe, pasi u redaktua, lexua nga ortaku themelues, miratohet ne parim dhe nen per nen nga ortaku themelues te shoqerise dhe nenshkruhet prej tij ne të gjitha kopjet. Ky statut hyn ne fuqi menjehere pas rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

FLAVIO ELIA

